

Simbolika e kalit

Rreth poezisë "KUAJT" të Gjekë Marinajt, botuar në revistën "DRITA" nr. 33 (1554), 19 gusht 1990

Poezia "Kuajt" e Gjekë Marinajt, ngërthen përmbajtjen e ndjenjave dhe të problemeve shpirtërore të shoqërisë shqiptare në fillim të viteve '90, si dhe paraqet zemërimin e autorit me vokacionet dhe provokacionet e jetës, duke ia mundësuar atij që të shprehë mjaft shprehshëm botën e tij të mbrendshme përmes vargut poetik. Në planin artistik poezia nuk mund të veçohet as të rreshtohet ndër poezitë më të mira të shkruara gjatë asaj kohe. Vargu i kësaj poezie është i çiltër ku e përcjellin çrregullsitë e rimës pa pretendime për sforcime me mjete të forta artistike, por gjithsesi një poezi e lezetshme për t'u lexuar, e realizuar në konceptin filozofik e sidomos nga këndi i metaforave është i pajisur varg për varg duke bërë të mundur që t'i bihet deri në fund me një hov.

Kuajt e këtij vargu poetik janë figurat e gjalla njerëzore që veprimet e tyre ngjasojnë me ato të kuajve të rëndomtë, sepse siç thotë autori "Tërë jetën duke vrapuar rrimë/

Gjekë Marinaj

Kuajt

Tërë jetën duke vrapuar rrimë
Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim;
Heshtim,
Dëgjojmë;
Hamë atë ç'na japin,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendjehollë.
Kush qe kalë mbreti,
Posti qe i lartë
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë
Kush qe kalë fshatari
Pat samarë me kashtë
Kush qe kalë i egër
Tërë jetën fjeti jashtë.
Po qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!

Shohim veç përpara/ Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë". Çështje e vërteta kuajt janë kafshë njëhundra, të forta dhe të shkathëta, me trup të madh, të mbuluar me qime të buta e të shkurtra, me bisht të gjatë e me jele, që shërbejnë për t'u hipur e për të vrapuar. E po hyzmeçarët e pushtetit diktatorial çfarë ishin: Ata ishin njerëz që mbathnin këpucë, sandale po më shumë çizme. Numri dhe formati i tyre nuk përcaktohej, as taket që lenin gjumët e ndryshme, të cilat ngjasonin me ato të njëhundraorëve nuk përcaktoheshin. Përgjimet e këtyre figurave surreale ishin të shkathëta. Trupi i tyre sa do i vogël që ishte stërzmadhohej në përmasat e përbindshave, dhe jo rrall ato mistifikoheshin me një sjellje të butë, por që nuk zgjaste shumë sepse misioni i tyre tashmë ishte i çartë. Ata ishin tjetërsue tamam në kuaj ku ju hipnin e ju zbritnin sa herë që të donin eporet e tyre. Po kështu figuracioni i mundshëm tërhiqet edhe mepërmasat simbolikave të tjera që posedojnë kuajt dhe ajo raca njerëzore që është vënë në funksion të përditshmërisë politike të asaj diktature që kishte mbetur gërxhall me atë pafuqin që e posedon edhe kali i ngordhur. Sikurse që veprimet e tyre ishin veprime të egra dhe pa fryte, tamam sikurse të ishin mbarsuar me atë farën e kuajve të tredhur. Pastaj kuajt janë të bardhë, pullali, sikurse që janë: kuaj karroce, vrapimi, barre, kalë për ngarkesë, samari dhe kuaj shale e race etj. Por edhe sistemi diktatorial kishte lënë pakë e më pakë politikaj me një vitalitet të një race vitale, por gjithësesi ata që vraponin ju ngjasonin kuajve.

Po ashtu kuajt janë kafshë emrat e të cilëve na japin mundësinë figurative për të shpjeguar shumë çështje, për të injoruar apo në mënyrë figurative për të akceptuar se nuk e çoi deri në fund një punë të nisur. Kur binte nga pozita e lartë që kishte dikush po kur e shkarkonin nga ndonjë post gjithmon thuhej se ra nga kali. Prandaj autori me të drejtë konstaton



Leonardo da Vinçi: „Kali“

për emruesin e përbashkët: „Të gjithëve kuaj na thonë. Nuk qajmë, nuk qeshim, dëgjojmë, hamë atë ç'na japin, ecim nga na thonë...“, dhe të gjitha këto veprime janë të përgjuara nga instikti i vet lëvizjes sepse „asnjë nga (kuajt) s'është mendje hollë“. Lëvizjet e kastës politike të sistemit komunist, veprimet e tyre nuk janë të imagjinuara, ato pozita kshin lëvizje regresive për shoqërinë shqiptare prandaj autori me kulturë të rrallë bënë rënglistën e kuajve: „Kush qe kalë mbreti/ posti qe i lartë/ Kush qe kalë princeshe/ i bënë shalë të artë/ Kush qe kalë fshatari/ pat samarë me kashtë/ Kush qe kalë i egër/ tërë jetën fjeti jashtë“. Rëngima e këtyre vargjeve jua prishi rehatinë pushtetarëve të cilët „qenë dhe mbetën më kuaj se sa vetë kuajt e kësaj poezie“.

Poezia shkaktoi ulurima ndër ulurimtarët e sistemit. Ata zëra vinin të çmendur dhe në çdo moment duhej të ndodhte e papritura. Veprimi i autorit për t'u reshtur rrezikut del si hapi më i mençur i asaj kohe për ti ikur kontaktit me ata që hingëllinin se „qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!“.

Sh. Dibrani

Minitregimi

Një gur të çmueshëm për të dashurën time!

Musa Ramadani

Ndërsa ende ëndërroja një dëshirë pasionale: t'ia bleja të dashurës sime një gur të çmueshëm për ditëlindje, sakaq isha bërë pasunar, banknotat nuk më dhimbeshin, të dashurën time e adhuroja si kult.

Vajta te dyqani i stolive të shtrenjta dhe hyra brenda gjithë kënaqësi. Në tezgat-vitrinat, veshur me qelq, soditja përgjigje të vegjël diamantësh, margaritarësh, safirësh, topazësh, ametistësh, tirkizësh, rubinësh dhe smaragadësh. Tek i vështroja nga lart, mahnitesha me ngjyrrat, vizullimet dhe mimikëritë e tyre të nduarnduarta. Cili burrë do ta gëzonte të dashurën? Zgjata dorën

kah margaritarët, kur diç më përshpërirti në vesh: ata janë pikla hane, rrëzëllejnë natën dhe mbrojnë nga rrezatet e sëmundjet!

Desha të merrja një safir, në vesh më erdhi një zë: ai është gur i kaltër mbretërisht, mbron nga lakmia dhe josh dhuntinë hyjnore! U prira sipër topzait, dikush më foli: ai është gur për qetësim, dikur besohet se ndihmon për t'u bërë i pasur dhe bujar! Ametisti nuk më fascinoi shumë, sepse dëgjova vërejtjen: është gur i Kleopatërës, mbron nga alkoolizmi dhe ruan besnikërinë e burrit! Kur ia qasa tirkizëve, dora më ngeli pezull nga hamendja: nëse femra është e pabesë, ky gur e ndryshon sakaq ngjyrrën dhe nëse s'blibet po merret dburatë, të ruan prej rrëzimit nga kali! Ta marr një rubin, thashë vetë me vetë, pa le të

dalë ku të dalë, porse fjalët në jehonë porosinin: edhe ky gur e ndryshon ngjyrrën: po qe se nadoh të afrohet armiku, kontrollon epshtet dhe qetëson! Tash më mbeti të zgjidhja ndërmyet përgjigje të vogël të diamanteve dhe atij të smaragdeve.

Vëndosa: një gur diamanti, pagova, e futa në xhep, mirëpo taksa dola nga dera e dyqanit, vezullimi i tij ma iritoi shpirtin, këmbët m'u shtangën dhe u rrezova në trotuar. Desha ta ktheja, po shitësi refuzoi. Për smaragrinë, himnizonte lunturinë. Çudi, se si askush nuk më përshpërirti, asgjë s'më foli dhe asnjë zë nuk më erdhi në vesh kur e zgjata dorën dhe e bleva diamantin. Nuk e dija se guri i tij sillka fatkeqësinë... ndërsa smaragdi, megjithëse m'i verboi sytë, dyshoja që sjell harmoni.

Si t'ia dërgoj tashti të dashurës diamantin për ditëlindje?!

Kjo klithmë më zgjoi nga ankthi i ëndrrës pa një para në xhep.

E, pra, aq fort e adhuroja të dashurën time si kult, aq fort!

Poezi

Mimoza Ahmeti

Ajo që ti do, do të ndodhë patjetër

Kapricoze natyra u shfaq te ti
duke kërkuar edhe një herë të drejtën e ribërjes.
Përtëritja, mëma e përjetësisë,
të lindi ty racë dhe gjak tjetër,
të janë mërçitur njerëzit e vjetër.
Dua pra, se do të ndodhë patjetër.
Do të ndodhë ajo që sot vibron në hije,
ajo që dridhërimthi ty ndërmend të bie
Me vete ke veç yjet dhe natën.
Nata është e rrezikshme dhe e çmendur.
Të dubet ty një terr i tillë, i dendur,
që të fshihen macet e zeza të ditës
dhe ty të ndriçojë mendimi rrezëllitës
i një tjetër drite, i një race tjetër.
Dua pra, se do të ndodhë patjetër.
1990

Ende herët

Ç'do të bëjnë ata femijë
me flokët - heje nga të palarët,
ajo vajzërishtë me kërpudhën e grisur
të fundit përmbi pantallona?
Çdo të thotë ajo shtëpi fshati
me gojë e vockla të dyerve,
nga ku në vend të fjalës
teptis një e lehur geni?
Ç'do të bëjë silueti im
në pluhërishtën e udhës së verdhë?
Nervi im kryengritës
vritet në vend që të vrasë...
1987

Letër Mamkës

Mamka,
mos ta lexojë këtë letër tjetërkush veç teje,
jo se sekrete, por edhe nuk jam e fortë plotësisht
për t'i mundur këto që po të them:
Tirana është fare e zokontë
me ngushtësinë e shtëpive të ulta,
me udhët e lodhura të dimrit,
me një pesëmbëdhjetëkatësh në qendër
ngritur si utopia ime,
me roje të përforcuara në udhëkryqet ambasadash,
me policë - gukapikë qershori të zbehur.
Diç parandehje, mamaka!
Kurrë shteti nuk ka qenë kaq përballë njeriut,
Kurrë tradhëtia e burrave nuk ka qenë më në modë
Kurrë gjumë më të rëndë nuk kam fjetur netët
dhe gratë më të humbura, më të zbrazura.
Po të them, e dashur, rreziku po më fton duke qeshur
me gojën pa dhembë të një dashurie kafshuese,
me çarje në karakter,
që është një pjesë e çarjesh shoqërore,
po më ofrohen detyra, miq e të njohur të shumtë,
të gjithë të lartë nga emrat,
por të ulët nga tensioni i jetës,
përpigjen të më ngrenë duke u kapur pas meje,
po më rrezojnë ende pa u ngitur.
E dashur, dëgjomë pa shqetësim,
unë do t'i grij, do t'i ngrij, po të them,
si në makinën e mishit
në vargjet e mia.